


Tregtia e jashtme e mallrave

Janar 2024

Tiranë, më 19 Shkurt 2024: Në Janar 2024 eksportet e mallrave arritën vlerën 29 mld lekë, duke u ulur me 29,2 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë dhe me 20,7 %, në krahasim me Dhjetor 2023. Importet e mallrave arritën vlerën 60 mld lekë, duke u rritur me 3,4 %, në krahasim me një vit më parë dhe duke u ulur me -17,3 %, në krahasim me Dhjetor 2023. Defiçiti tregtar i këtij muaji është 30 mld lekë, duke u rritur me 88,6 %, krahasuar me Janar 2024 dhe ulur me -13,5 %, në krahasim me Dhjetor 2023.


Fig. 1 Ndryshimi vjetor në Tregtinë e mallrave (%)



Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të eksporteve:

Gjatë muajit Janar 2024, në uljen e eksporteve prej 29,2 %, kanë ndikuar kryesisht grupet: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me -19,5 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -5,0 pikë përqindje, dhe “Materiale ndërtimi dhe metale” me -3,8 pikë përqindje, etj. Ndërsa pozitivisht kanë ndikuar grupet: “Produkte kimike dhe plastike” me +0,3 pikë përqindje dhe “Ushqime, pije, duhan” me +0,1 pikë përqindje.


Fig. 2 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të eksporteve, Janar 2024



Kontributi i grupeve kryesore në ndryshimin vjetor të importeve:

Gjatë muajit Janar 2024, në rritjen e importeve prej 3,4 %, krahasuar me Janar 2023, pozitivisht kanë ndikuar kryesisht grupet: “Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi” me +4,7 pikë përqindje, “Materiale ndërtimi dhe metale” me +2,9 pikë përqindje, “Ushqim, pije, duhan” me +0,2 pikë përqindje, etj. Ndërsa në uljen e importeve kanë ndikuar kryesisht grupet: “Minerale, lëndë djegëse dhe energji elektrike” me -3,0 pikë përqindje, “Tekstile dhe këpucë” me -1,0 pikë përqindje, “Lëkurë dhe artikujt prej tyre” me -0,3 pikë përqindje, etj.

Fig. 3 Kontributi i grupeve në ndryshimin vjetor të importeve, Janar 2024




Ecuria e tregtisë së mallrave sipas vendeve partnere

Në muajin Janar 2024, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur ulje më të madhe të eksporteve, në krahasim me Janar 2023 janë: Italia (7,6 %), Kosova (20,1 %) dhe Gjermania (34,7 %). Ndërsa vendet me të cilat eksportet kanë pasur rritjen më të madhe, janë: Kroacia (59,3 %) dhe Austria (17,6 %).

Në muajin Janar 2024, vendet me të cilët Shqipëria ka pasur rritjen më të madhe te importeve, janë: Italia (2,7 %), Kina (2,1 %) dhe Greqia (36,3 %). Ndërsa vendet me të cilat importet kanë pasur uljen më të madhe, në krahasim me Janar 2023 janë: Turqia (5,6 %), Spanja (16,4%), dhe Maqedonia e Veriut (5,1 %).

Fig. 4 Tregtia e jashtme e mallrave sipas disa vendeve të BE-së, Janar 2024



Shkëmbimet tregtare me vendet e BE-së zënë 58,4 %, të gjithë tregtisë së mallrave. Në Janar 2024, eksportet drejt vendeve të BE-së zënë 77,8 % të eksporteve gjithsej dhe importet nga vendet e BE-së zënë 48,9 % të importeve gjithsej.

Partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë janë: Italia (29,7 %), Greqia (7,7 %) Turqia (7,6 %) dhe Gjermania (7,0 %).

Tab. 1 Qarkullimi i mallrave, Janar 2024

Vitet	Muajt	Eksporte	Ndryshimi	Importe	Ndryshimi	Bilanci	Mbulimi
2000		37	-23,5	157	-1,5	-120	23,6
2001		44	19,1	190	21,0	-146	23,2
2002		47	7,7	210	10,6	-163	22,6
2003		54	14,7	226	7,4	-172	24,1
2004		62	14,0	236	4,5	-174	26,3
2005		66	6,0	262	11,1	-196	25,1
2006		77	17,6	299	14,1	-222	25,9
2007		97	25,5	376	25,8	-279	25,8
2008		113	15,8	440	16,9	-327	25,6
2009		105	-7,2	429	-2,5	-324	24,4
2010		162	54,6	478	11,4	-316	33,8
2011		197	21,9	544	13,9	-347	36,2
2012		213	8,2	528	-2,9	-315	40,3
2013		246	15,7	517	-2,1	-271	47,6
2014		256	3,8	552	6,7	-296	46,3
2015		243	-4,9	545	-1,4	-302	44,7
2016		243	0,1	579	6,4	-336	42,0
2017		273	12,1	626		-353	43,6
2018		310	13,7	641	2,4	-331	48,4
2019		299	-3,8	649	1,2	-350	46,0
2021		272	-9,0	605	-6,8	-333	44,9
2022		487	32,0	950	18,7	-464	51,2
2023		440	-9,5	873	-8,2	-432	50,5
2022	01 - 22	35	47,5	55	21,1	-20	63,6
	02 - 22	37	50,5	69	31,5	-31	54,3
	03 - 22	48	50,4	84	29,7	-36	57,1
	04 - 22	42	46,6	78	23,7	-36	54,0
	05 - 22	45	36,8	80	28,6	-35	56,4
	06 - 22	46	32,2	81	20,8	-35	56,8
	07 - 22	39	23,0	82	14,1	-42	48,3
	08 - 22	35	48,1	80	30,8	-44	44,2
	09 - 22	39	16,3	88	27,4	-49	43,8
	10 - 22	38	12,5	83	8,6	-45	45,9
	11 - 22	42	12,9	77	-3,9	-35	54,4
	12 - 22	40	26,1	95	7,7	-54	42,5
	Janar– Dhjetor 22	487	32,0	950	18,7	-464	51,2
2023	01 - 23	42	20,2	58	5,8	-16	72,3
	02 - 23	38	2,8	69	1,1	-31	55,2
	03 - 23	42	-11,7	81	-3,7	-38	52,3
	04 - 23	34	-19,2	75	-3,9	-41	45,4
	05 - 23	40	-11,7	81	1,2	-41	49,2
	06 - 23	38	-17,3	75	-7,5	-37	50,7
	07 - 23	38	-4,0	71	-13,6	-33	53,7
	08 - 23	27	-21,9	68	-15,0	-40	40,6
	09 - 23	34	-12,8	73	-16,6	-40	45,8
	10 - 23	37	-4,3	78	-6,3	-42	46,8
	11 - 23	33	-21,8	72	-7,4	-39	46,0
	12 - 23	38	-6,6	73	-23,1	-35	51,7
	Janar– Dhjetor 23	440	-9,5	873	-8,2	-432	50,5
2024	01 - 24	30	-29,2	60	3,4	-30	49,5

Tab. 2 Tregtia e jashtme e mallrave sipas vendeve partnere (milionë lekë), Janar 2024

	Eksporte		Importe	
	Janar 2023	Janar 2024	Janar 2023	Janar 2024
Vendet e BE-së	28.968	23.178	28.470	29.415
Austri	215	253	413	540
Gjermani	3.064	2.002	3.832	4.318
Greqi	3.349	1.864	3.687	5.026
Itali	15.747	14.552	11.849	12.166
Spanjë	2.117	973	964	806
Kroaci	376	599	463	189
Të tjera të BE-së	4.100	2.935	7.262	6.370
Mbretëri e Bashkuar	178	103	468	485
Kinë	560	280	5.804	5.923
Kosovë	3.602	2.879	1.045	712
Maqedonia e Veriut	4.442	746	818	777
Rusi	3	-	451	73
SHBA	483	387	1.323	2.851
Turqi	571	531	6.672	6.297
Ukrainë	135	9	346	588
Zvicër	1.065	77	542	361
Të tjera	2.071	1.603	12.259	12.715
Gjithsej	42.079	29.793	58.198	60.196

Tab. 3 Tregtia e jashtme sipas grup mallrave (milionë lekë). Janar 2024

Grup-mallrat	Eksporte		Importe	
	Janar 2023	Janar 2024	Janar 2023	Janar 2024
Gjithsej	42.079	29.793	58.198	60.196
Ushqime, pije, duhan	3.578	3.620	9.791	9.916
Minerale, lëndë djegëse, en.el.	13.869	5.648	8.106	6.357
Produkte kimike dhe plastike	1.011	1.158	7.154	7.165
Lëkurë dhe artikujt prej tyre	262	177	953	782
Prodhime druri dhe letre	995	787	1.765	1.713
Tekstile dhe këpucë	11.355	9.243	6.394	5.808
Materiale ndërtimi dhe metale	7.070	5.484	9.069	10.753
Makineri, pajisje dhe pj. këmb.	3.136	2.891	12.595	15.304
Të tjera	801	785	2.371	2.398

Tab. 4 Të dhënat progresive të eksporteve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë). Janar 2024

	Itali		Kosovë		Greqi		Gjermani	
	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024
Gjithsej	15.747	14.552	3.602	2.879	3.349	1.864	3.064	2.002
Ushqim. pije duhan	1.086	1.253	400	388	402	370	200	136
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	219	1.009	1.329	886	1.861	367	1.724	719
Produkte kimike dhe plastike	477	554	231	209	70	67	4	1
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	248	156	0	0	7	17	1	0
Prodhime druri dhe letre	637	468	69	83	147	117	10	6
Tekstile dhe këpucë	8.935	6.968	10	11	474	610	765	881
Materiale ndërtimi dhe metale	2.245	2.072	1.337	1.048	324	258	113	68
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	1.497	1.648	144	148	4	7	212	146
Të tjera	405	425	82	106	58	51	35	44

Tab. 5 Të dhënat progresive të importeve sipas grup mallrave dhe partnerëve kryesorë (milionë lekë). Janar 2024

	Itali		Kinë		Turqi		Greqi	
	2023	2024	2023	2024	2023	2024	2023	2024
Gjithsej	11.849	12.166	5.804	5.923	6.672	6.297	3.687	5.026
Ushqim. pije duhan	1.990	2.261	98	139	382	435	1.264	1.300
Minerale. lëndë djegëse. energji elektrike	71	153	1	2	596	818	502	1.166
Produkte kimike dhe plastike	1.358	1.438	608	559	955	798	549	902
Lëkurë dhe artikuj prej lëkure	768	561	56	72	24	28	2	12
Prodhime druri dhe letre	482	386	111	102	247	311	230	249
Tekstile dhe këpucë	2.919	2.412	796	1.023	1.037	827	359	500
Materiale ndërtimi dhe metale	1.480	1.366	930	775	2.272	2.106	441	589
Makineri. pajisje dhe pjesë këmbimi	2.330	3.024	2.729	2.769	822	701	187	203
Të tjera	450	565	474	482	337	272	153	106

Metodologjia

Tregtia e Jashtme e mallrave është një publikim periodik mujor që paraqet tregtinë e mallrave të Shqipërisë me vendet e tjera të botës. Të dhënat e përpunuara nga INSTAT për këtë publikim janë të dhëna administrative të cilat merren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Definicionet:

Eksportet janë në përgjithësi mallra të destinuara tek një vend i tretë, të vendosura nën regjimin doganor, në përpunimin pasiv ose të riekportuar pas përpunimit aktiv.

Vlera F.O.B: Është vlera e mallrave të eksportuara deri në kufirin e vendit eksportues, pra përfshin koston e mallrave të eksportuara dhe shpenzimet deri në kufi të vendit eksportues.

Importet janë në përgjithësi mallra që vinë nga një vend i tretë, të vendosura direkt në qarkullim të lirë ose që qëndrojnë në magazinat e ruajtjes nën procedurat doganore të lejimit për qarkullim të lirë, për përpunim aktiv ose për përpunim nën kontrollin doganor.

Vlera C.I.F: Është vlera e mallrave të importuara dërguar deri në kufirin e vendit importues, pra përfshin koston e mallit edhe shpenzimet e transportit dhe sigurimit deri në kufirin e vendit që importon mallrat.

Nomenklatura e Kombinuar (NK) është një nomenklaturë mallrash e përdorur për statistikat e tregtisë ndërkombëtare të mallrave dhe për tarifatat doganore.

<http://www.instat.gov.al/al/metodologji/klasifikime-nomenklatura.aspx>;

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian: Belgjikë, Gjermani, Francë, Itali, Luksemburg, Holandë, Danimarkë, Irlandë, Greqi, Spanjë, Portugali, Austri, Finlandë, Suedi, Qipro, Çeki, Estoni, Hungari, Letoni, Lituani, Maltë, Poloni, Sllovaki, Slloveni, Bullgari, Rumani, Kroaci.

Shpjegimi i simboleve

(0) vlerë më e vogël se gjysma e njësisë matëse

(-) pa vlerë

(÷) deri